



ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Rishqyrtim të dt.09.02.2021 nga Operatori Ekonomik “**Consult engineering shpk**” Shpk lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Hartimi i projekteve**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-156-2-2-1, nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik “**Consult engineering shpk**” me date 09.02.2021, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Hartimi i projekteve**” me Nr. të prokurimit 615-21-156-2-2-1 kundër Njoftimit për kontrate të datës 26.01.2021. të publikuar në ueb-faqe të KRPP-ës.
2. **Vërtetohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik “**Consult engineering shpk**” me date 09.02.2021, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Hartimi i projekteve**” me Nr. të prokurimit 615-21-156-2-2-1 kundër Njoftimit për kontrate të datës 26.01.2021. të publikuar në ueb-faqe të KRPP-ës.
3. **Autoriteti Kontraktues** vendos të bejë ndryshimet në piken ankimore të Parashtruara nga Operatori Ekonomik gjegjësisht kërkesën e Autoritetit kontraktues sa i përket 2 inxhinierëve të ndërtimtarisë në drejtimin infrastrukturë Rrugores me nga 4 vite përvojë pune **ne 3 vite përvojë pune** dhe të vazhdoj zgjatjen e afatit të dorëzimit të ofertave në përputhje me nenin 53 të LPP-ës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqen: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetimi

Operatori Ekonomik “Consult engineering shpk” me date 09.02.2021, ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “Hartimi i projekteve” me Nr. te prokurimit 615-21-156-2-2-1 kundër Njoftimit për kontrate te datës 26.01.2021. Autoriteti Kontraktues me date 12.02.2021. ka shqyrtuar kërkesën ne fjale dhe ka ardh ne përfundim si ne vijim:

Pas analizimit te pretendimeve ankimore AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim **është pjesërisht e bazuar** dhe njëra nga pikat ankimore qëndron.

Autoriteti Kontraktues vendos te beje ndryshimet ne piken ankimore te Parashtruara nga Operatori Ekonomik ndaj kërkesës se Autoritetit kontraktues sa i përket 2 inxhinierve te ndërtimtarisë ne drejtimin infrastrukturë Rrugores me nga 4 vite përvoje pune **ne 3 vite përvojë pune** dhe te vazhdoj zgjatjen e afatit te dorëzimit te ofertave ne përputhje me nenin 53 te LPP-ës.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor nga ana juaj që nuk gjinden inxhinier të kësaj lëmie, kjo pike nuk **qëndron** ngase sipas informatave zyrtare qe ne i posedojmë ky drejtim në UP ekziston që nga viti 2010 dhe po ashtu ka shumë inxhinier në Kosovë ne këte lëmi.

Pra duke marre para sysh rendësin e këtij projekti dhe projektet që do te realizohen nga kompania e kontraktuar është më se e nevojshme që të jenë së paku 2 inxhinier të kësaj lëmie dhe patjetër që nevojitet edhe përvoje e mjaftueshme për realizimin e projekteve të KK Podujeve, gjithashtu vlera e projekteve investive në infrastrukturë kalon vlerën mbi 3.000.000.00 Euro, dhe për implementim te këtij projekti nevojiten profesionist të kësaj lëmie.

Nga se u cek, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/I-092, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar ne ato qe u than me lart vendosur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në OSHP.

Nr. 14-370/09-001 2034/21
Podujevë,
12.02.2021

